

VENDIM
Nr.761, datë 19.11.2004

PËR KRIJIMIN E ARKIVIT QENDROR PËR SISTEMIMIN, RUAJTJEN DHE SHFRYTËZIMIN E DOKUMENTACIONIT TË PERIUDHËS SË SIGURIMIT PRANË INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE

(Ndryshuar me VKM nr. 727, datë 28.5.2008)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 2 shkronja “c” e 3 të nenit 9 të ligjit nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e arkivit qendror për sistemimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e dokumentacionit të periudhës së sigurimit, pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Rrjeti i këtij arkivi të shtrihet në drejtoritë rajonale të sigurimeve shoqërore.

2. Drejtoritë rajonale të sigurimeve shoqërore të mbledhin, *brenda datës 30.4.2009*, dokumentacionin e periudhës së sigurimit për ndërmarrjet dhe institucionet, buxhetore e jobuxhetore, që kanë ndërprerë veprimtarinë, si dhe për ndërmarrjet që, për arsye të reformës, ushtrojnë veprimtari të kufizuar.

3. Ndërmarrjet dhe institucionet, buxhetore e jobuxhetore, që do ta mbyllin veprimtarinë apo do ta kufizojnë atë pas datës 30.6.2005, detyrohen të dorëzojnë dokumentacionin e periudhës së sigurimit të punonjësve të tyre në drejtoritë rajonale të sigurimeve shoqërore.

4. Në këtë dokumentacion përfshihen regjistrat themeltarë, listëpagesat dhe çdo dokument tjetër që ka lidhje me periudhën e sigurimit ose prej të cilave burojnë të drejta nga sigurimet shoqërore.

5. Regjistrat themeltarë të dorëzohen në drejtoritë rajonale të sigurimeve shoqërore pasi dokumentacioni i periudhës së sigurimit të punonjësve të jetë përditësuar plotësisht, duke përpunur listëpagesat me regjistrat themeltarë dhe librezat e punës. Regjistrat themeltarë të mbyllen për çdo person.

Drejtoritë rajonale të sigurimeve shoqërore, para marrjes në dorëzim të këtij dokumentacioni, të numërtojnë, kontrollojnë dhe konfirmojnë saktësinë për çdo fletë të regjistrave themeltarë të vjetërsisë në punë.

6. Ndërmarrjet që zhvillojnë veprimtari të kufizuar, para se të dorëzojnë dokumentet e periudhës së sigurimit, ku është e gjithë periudha e punës, që nga krijimi, të hapin regjistra themeltarë të rinj vetëm për punonjësit që kanë në punë.

7. Instituti i Sigurimeve Shoqërore të marrë të gjitha masat për marrjen në dorëzim të dokumentacionit të periudhës së sigurimit nga fondkrijuesit dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit për sistemimin dhe ruajtjen e këtij dokumentacioni.

8. Dokumentacioni i periudhës së sigurimit të punonjësve të ndërmarrjeve shtetërore, ish-kooperativave bujqësore, institucioneve, i cili deri më tani është administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, të dorëzohet *brenda datës 30.4.2009* pranë strukturave të rrjetit të arkivit qendror të dokumenteve të periudhës së sigurimit.

9. Ngarkohen ministritë që kanë në varësi subjektet e përcaktuara në këtë vendim, *Ministria e Financave*, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për zbatimin e këtij vendimi.

10. Ngarkohen *Ministria e Financave*, Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të ndjekin procedurat për kalimin në përgjegjësi administrimi

të Institutit të Sigurimeve Shoqërore të mjediseve të gatshme, ku ndodhet dokumentacioni i periudhës së sigurimit.

11. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore të përcaktojnë një program pune për kalimin e dokumentacionit të periudhës së sigurimit.

12. Vendimi nr.464, datë 22.7.1998 i Këshillit të Ministrave “Për sistemimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e dokumentacionit të sigurimit të punonjësve të ish-kooperativave bujqësore, ndërmarrjeve dhe institucioneve që kanë ndërprerë veprimtarinë e tyre ose janë në procesin e mbylljes” shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano